

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ HR & Payroll për listëpagesat”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): “**Paketa software testimi programesh**”

VLERA E FONDIT LIMIT: 6.900.000 (gjashte million e nentëqind mijë)lek pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht 138.000 (njqind e tridhjetë e tete mijë)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$6.900.000 \times 30\% = 2.070.000$$

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshem gjatë 2(dy) viteve të fundit 2020, 2021. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 2(dy) viteve të fundit të konfirmuar nga administrata tatimore. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara 2020, 2021 nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006“Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.5.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kështesave prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht 2.070.000 (dy milion e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$6.900.000 \times 30\% = 2.070.000$$

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4. Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të sistemit të kërkuar , operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij 3 muajt e fundit punonjësit si më poshtë vijon:

- 2 (dy) specialist të certifikuar për zhvillim software i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akreditura sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtar të njohur nga Republika e Shqipërisë ose nga prodhues të paisjeve) i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatikë/ inxhinierike softwerike.
- 1 (një) specialist të certifikuar për pajisjet Server të sistemit i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akreditura sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtar të njohur nga Republika e Shqipërisë ose nga prodhues të paisjeve) i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/inxhinieri elektronike/ inxhinier informatike/inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatikë/ inxhinierike softwerike.

- 1 (nje) specialist te certifikuar per platformen aktuale të virtualizimit te perdorur ne datacenterin e UKT i pajisur me certifikimin përkatës (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akreditura sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtar të njohur nga Republika e Shqipërisë ose nga prodhues te paisjeve) i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor)shoqëruar me kontratë pune, diplomë në fushën IT teknologji informacioni/inxhinieri elektronike/inxhinier informatike/inxhinieri telekomukacioni/informatikë ekonomike/informatikë/inxhinierike softëerike.
- 1 (një) specialist të certifikuar PMI ose ekuivalente për menaxhimin e projektit, (të lëshuar nga subjekte kombëtare të akreditura sipas legjislacionit në fuqi ose organizma ndërkombëtar të njohur nga Republika e Shqipërisë ose nga prodhues te paisjeve) i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 muajt e fundit (Shtator- Tetor- Nëntor) shoqëruar me kontratë pune.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomat përkatëse, kontratat e punës si dhe certifikatat për secilin punonjës të kërkuar më lart.
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Shtator- Nëntor.
- Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme

Shënim: Për piken 2.4 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për

ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar specifikimeve në dosjen e procedurës dhe natyrës së përgjithshme të shërbimit që pritet të ofrohet.

2.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

2.7. Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 27001:2013 **(ose ekuivalente)** e vlefshme të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 27001:2013 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

2.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten ISO/IEC 20000-1:2018 (**ose ekuivalente**) e vlefshme të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO/IEC 20000-1:2018 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 27001-2013 ofron përmbledhjen e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS). Ai gjithashtu ofron terma dhe përkufizime që përdoren zakonisht në familjen e standardeve ISMS.

ISO 20000-1 për Menaxhimin e shërbimeve IT (Formalisht: ISO/IEC 20000-1:2018 ('pjesa 1')) specifikon kërkesat për "krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit (SMS). Një SMS mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të

shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimi, tranzicioni, ofrimi dhe përmirësimi i shërbimeve, të cilat plotësojnë kërkesat e dakorduara dhe japin vlerë për klientët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbimet.")

ARGUMENTIM

MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE

Argumentim i specifikimeve teknike (HR & Payroll)

Si rezultat i kërkesave të vazhdueshme të ardhura nga Drejtoria e Burimeve Njerezore për nevojën e një database elektronik të punonjësve mbi të cilin do të ngrihen funksionalitete specifike që do të lehtësojnë mbarevajtjen e punës, është hartuar një zgjidhje e përshtatur në specifikimet teknike.

Sistemi i paraqitur do të instalohej në zyrat qendrore (në server room qendror) për arsye sigurie të dhënash dhe mundësi për tu aksesuar nga të gjithë userat.

Përdoruesit do të jenë të limituar vetëm në bazë të kërkesave që do të vijnë nga departamentet, miratuar nga drejtoret përkatëse, për shkak të të dhënave sensitive që gjenden aty.

Komunikimi duhet të jetë i enkriptuar për shkak të sigurisë.

Gjuha e Interfases që do të përdoret do të jetë gjuha shqipe, çka do të thjeshtojë përdorimin e sistemit.

Database do të ketë mundësi regjistrimi për të pakten 2000 punonjës, pasi aktualisht janë të punësuar mbi 1300 punonjës duke lënë dhe hapësirë për shtim të mundshëm të stafit,

Sistemi do të mundësojë backup (mekanizma Cron jobs) të vazhdueshëm lokalisht për të shmangur humbjen e të dhënave.

Fushat e sistemit do të jenë në varesi të kërkesave që do të vijnë nga departamentet, në mënyrë që çdo funksionalitet i ofruar nga sistemi të jetë i përdorshëm.

Çdo specifikim tjetër është i shpjeguar më sipër.

Njësia e prokurimit